



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SH.A UJËSJELLËS –KANALIZIME VAU DEJËS
ASAMBLEJA E AKSIONARËVE

Nr. 4387 Prot.

Vau Dejës, më 17.07.2023

Vendim

Nr. 26 Datë 17/07/2023

**PËR
PRISHJEN DHE SHPALLJEN NË LIKUIDIM TË SHOQËRISË UK VAU DEJËS
SH.A**

Në mbështetje të nenit 135 të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “ Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare” ndryshuar; të Statutit të Shoqërisë UK Vau i Dejës Sh.a; të Kreut II, të VKM Nr.302, datë 11.05.2022 “ Pë politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”; të nenit 7, pika 6, të Marrëveshjes për Krijimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Qarku Shkodër SH.A, të lidhur midis Bashkive Malësi e Madhe, Pukë, Vau Dejës dhe Fushë-Arrëz dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë datë 19.01.2023, si dhe të Vendimit të Këshillit Bashkiak Vau Dejës Nr. 09, datë 27.02.2023 “Për miratimin e Marrëveshjes dhe pjesëmarrjen e Bashkisë Vau i Dejës në Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Qarku Shkodër SH.A, me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura”, Asambleja e Përgjithshme të Aksionarëve”, Meqenëse shoqëria e ka transferuar veprimtarinë ekonomike si dhe aktivet dhe detyrimet e saj në tërësi në datën 30.06.2023 dhe kjo shoqëri nuk ka më të drejta të zhvillojë aktivitetin për të cilin ajo është themeluar, nuk ka më arsye të vijojë ekzistencën e saj.

VENDOSI:

1. Përfundimin e aktivitetit të shoqërisë dhe prishjen e saj. Shoqëria shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese.
2. Administratori i shoqërisë Z. Ilir Baba është larguar nga detyra me dorëheqje dhe emërohet Z. Prend Ndoci si likuidator të shoqërisë.
3. Likuidatori është i autorizuar të përgatisë Raportin Përfundimtar të likuidimit të shoqërisë. Ai është gjithashtu i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për likuidimin e shoqërisë si dhe të kërkojë, paraqesë çdo dokument të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likuidimin e shoqërisë
4. Ngarkohet Z.Prend Ndoci për ngarkimin e këtij vendimi në QKB.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E AKSIONAREVE TË UK VAU I DEJËS SH.A
KRYETAR I BASHKISË VAU DEJËS
KRISTIAN SHKRELI

Kristian Shkrel

